

20120952448

L I G J
PËR SHPALLJE TË TERESISE MONUMENTALE TE KRUSHEVES TRASHEGIMI
KULTURORE ME RENDESI TË VECANTE

DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Neni 1

(1) Teresia monumentale e Krusheves, që paraqet kompleks të arkitektures së vjetër të qytetit dhe ka rendesi të madhe kulturore dhe historike lidhur me historinë nacionale dhe kulturën e Republikës së Maqedonisë, shpallet trashëgimi kulturore me rendesi të vecante, nenkategoria - rendesi e madhe (në tekstin e mëtejme: "Teresia monumentale e Krusheves").

(2) Me shpalljen e "Teresise monumentale të Krusheves" trashëgimi kulturore me rendesi të vecante, mundësohet:

- shenimi dhe ruajtja më kualitative e traditave të "Kryengritjes së Ilindenit" dhe "Republikës së Krusheves" nga viti 1903;

- ruajtja e përhershme e vlerave historike, arkitektonike, urbane, ndërtuese, ambientale, artistike, etnologjike, pa dallim nëse janë të karakterit profan dhe sakral dhe cilit konfesion dhe kulture u takojnë si dhe e autenticitetit, raritetit, unitetit, diversitetit, integritetit, ruajtjes dhe vjetërsisë së "Teresise monumentale të Krusheves";

- krijimi i kushteve të volitshme për mbijetesë dhe ruajtje të integritetit për të gjitha të dhënat që i barten në vetë si dëshmi;

- përhapja e njohurive për vlerat, rendesinë dhe rolin e saj në identifikimin kulturor;

- aftësimi që të shërbejë për plotësimin e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, ekonomike, turistike dhe nevojave tjera të qytetareve dhe

- parandalimi i veprimeve, dukurive dhe ndikimeve me të cilat bëhet apo mund shkaktohet dëmtimi apo degradimi i saj.

(3) "Teresia monumentale e Krusheves" është krijuar në periudhën nga shekulli XV deri në shekullin e XIX, si trashëgimi kulturore me rendesi të vecante, është me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë dhe gëzon mbrojtje të vecante që realizohet në përputhje me këtë ligj, me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe me ligj tjetër.

Neni 2

(1) Në "Teresinë monumentale të Krusheves" përfshihen qendra e vjetër e qytetit me qarshinë e Krusheves dhe të mirat e mbrojtura të vecanta, me vlera, rendesi dhe funksion të ndryshëm.

(2) "Teresia monumentale e Krusheves", si dhe të gjitha të mirat e mbrojtura të vecanta në kuadër të saj, mbrohen në pajtim me regjimin e mbrojtjes të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe akteve të vecanta për shpalljen e tyre trashëgimi kulturore.

Neni 3

(1) "Teresia monumentale e Krusheves" është me sipërfaqe të përgjithshme prej 44 ha dhe është në lartësinë mbidetare si vijon:

- Kuota më e ulët (në hyrje të qytetit) ..1180 l.m.m. dhe

- Kuota më e lartë 1286 l.m.m.

(2) Koordinatat e "Teresise monumentale të Krusheves" janë:

- Më lindorja.....X: 521926,769 Y: 580430,334

- Më jugorja.....X: 521430,166 Y: 579750,816

- Më perëndimorja...X: 520487,953 Y: 580752,137 dhe

- Më veriorja.....X: 521047,412 Y: 581086,425

(3) Kufijte e "Teresise monumentale të Krusheves" jane:

- LINDJE: Kufiri lindor fillon nga pika e prerjes e kufirit jugor të PK 4686 me kufirin perendimor të PK 4700, vazhdon drejt jugut neper kufirin perendimor të PK 4700, deri në piken prerese me kufirin jugperendimor të PK 4700, shkon neper kufirin jugperendimor të PK 4700 deri te pika e prerjes së boshtit të rruges "Niko Doaga" (PK 4739), shkon drejt jugperendimit në gjatesi prej 50 m. Pastaj vazhdon neper kufirin jugperendimor të PK nr. 4731 deri në kryqezimin me boshtin e deges së rruges "Niko Doaga" në gjatesi prej 22 m, pastaj kthehet në drejtim jugperendimor neper boshtin e rruges "Niko Doaga", në gjatesi prej 33 m, pastaj shkon drejt jugut, neper boshtin e rruges "Niko Doaga" në gjatesi prej 41,5 m. Kthen drejt perendimit neper boshtin e rruges "Niko Doaga" në gjatesi prej 5 m. Vazhdon drejt jugut neper kufirin perendimor të PK 5597/2 dhe PK 5599 deri te prerja me krahun e rruges "Niko Doaga" dhe vazhdon neper kufirin perendimor të PK 5606 dhe PK 5607 deri në prerjen me boshtin e krahut të rruges "Niko Doaga". Pastaj kufiri shkon në drejtimin jugperendimor neper boshtin e rruges "Niko Doaga" në gjatesi prej 66 m. Kthen neper boshtin e rruges "Niko Doaga" drejt perendimit në gjatesi prej 27 m. Pastaj kufiri shkon drejt jugut në gjatesi prej 8 m dhe vazhdon drejt juglindjes deri në te prerja me boshtin e rruges rajonale 516 Krusheve - Prilep. Pastaj shkon në jugperendim duke e ndjekur boshtin e rruges së njejte në gjatesi prej 145 m, e pastaj kthen drejt jugut neper kufirin perendimor dhe jugor të PK 5679, deri në prerjen me kufirin perendimor të PK 5698, deri në prerjen me rrugen "Partizanska" (PK 5723), e pret rrugen dhe vazhdon drejt jugut neper kufijte perendimore të PK 5700 dhe PK 5701, PK 5734, deri te prerja me boshtin e rruges "Pitu Guli" në gjatesi prej 7 m, e pastaj shkon drejt jugut në boshtin e rruges së njejte në gjatesi prej 104 m.

- JUG: Kufiri jugor i Teresise monumentale të Krusheves shkon drejt perendimit neper boshtin e rruges "Pitu Guli" në gjatesi prej 76 m, kthen drejt jugut neper kufirin verior të PK 6377 në gjatesi prej 17 m. Kthen drejt perendimit në gjatesi prej 34 m, pastaj shkon drjet veriut në gjatesi prej 20 m. Pastaj vazhdon të shkoje drejt jugut neper kufirin perendimor të PK 6377 në gjatesi prej 129 m, deri te prerja me kufirin verior të PK 6323, vazhdon të shkoje drejt perendimit neper kufirin verior të PK 6323 në gjatesi prej 183 m, deri në prerjen me boshtin e rruges "Koca Milenku" (PK 6512/1), e pret rrugen dhe shkon neper kufirin verior të PK 6227 në gjatesi prej 80 m. Pastaj kufiri vazhdon drejt veriut në gjatesi prej 15,5 m, duke e prere kthesen e rruges "Koca Milenku" deri në piken e prerjes të kufirit jugor dhe lindor të PK 6310, vazhdon drejt veriut në kufirit lindor të PK 6310 prerjen me boshtin e rruges "Koca Milenku", vazhdon të shkoje drejt perendimit neper boshtin e rruges "Koca Milenku" në gjatesi prej 151 m, deri te prerja me boshtin e rruges "Mancu Matak" (PK 5817).

- PERENDIM: Kufiri perendimor i "Teresise monumentale të Krusheves" shkon drejt veriut neper boshtin e rruges "Mancu Matak" në gjatesi prej 134 m, pastaj shkon drejt veriperendimit, duke e ndjekur boshtin e rruges "Mancu Matak" në gjatesi prej 140 m, deri në lidhjen me rrugen "Bllagoj Celev" (PK 5877). Pastaj kufiri vazhdon drejt veriut në gjatesi prej 60 m, neper boshtin e rruges "Bllagoj Celev" dhe të kendit në lindje të PK 6439, ku prehet me krahun e së njejtës rruge, kufiri thehet dhe shkon në verilindje në gjatesi prej 60 m. Pastaj kufiri vazhdon neper boshtin e rruges "Bllagoj Celev" drejt perendimit, pastaj shkon pak drejt veriperendimit, prape neper boshtin e rruges "Bllagoj Celev" në gjatesi prej 87 m, deri te pika e prerjes e boshtit të rruges "Bllagoja Celev" dhe rruges "Taqa Berber" (PK 6521). Kufiri vazhdon drejt veriut neper boshtin e rruges "Taqa Berber" në gjatesi prej 120 m, deri në lidhjen me krahun e rruges "Taqa Berber" në lindje të PK 4635, prej nga vazhdon neper boshtin e rruges "Taqa Berber" drejt veriut në gjatesi prej 45 m, kthen drejt perendimit neper krahun e rruges "Taqa Berber" në gjatesi prej 24 m, kthen drejt veriut neper boshtin e krahut të rruges "Taqa Berber" deri në prerjen me rrugen "Mishe Eftim" (PK 6509). Vazhdon drejt lindjes në gjatesi prej 115 m, kthen drejt veriut neper boshtin e rruges "Mishe Eftim" në gjatesi prej 87 m, deri te prerja me boshtin e rruges "Tome Nikle" (PK 6516), vazhdon neper boshtin e rruges "Tome Nikle" drejt

verilindjes në gjatesi prej 155 m, deri në prerjen me boshtin e rruges "Marshall Tito" (PK 6508/1), vazhdon drejt veriut neper boshtin e rruges "Marshall Tito" në gjatesi prej 21 m, deri te prerja e rruges "Nikolla Karev" (PK 6518) dhe

- VERI: Kufiri verior fillon nga pika e lidhjes së rruges "Marshall Tito" me rrugen "Nikolla Karev". Vazhdon në juglindje neper boshtin e rruges "Nikolla Karev" në gjatesi prej 140 m, deri te prerja me boshtin e rruges "Kiro Fetak" (PK 6507), pastaj vazhdon në lindje neper boshtin e rruges "Kiro Fetak" në gjatesi prej 135 m, deri te pika në jug të PK 4803, e pastaj vazhdon neper boshtin e rruges së njejte drejt juglindjes në gjatesi prej 120 m, deri te pika në jug të PK 4849. Kufiri shkon drejt verilindjes neper boshtin e rruges së njejte në gjatesi prej 42 m, deri te prerja me boshtin e rruges "Niko Doaga", vazhdon drejt lindjes në gjatesi prej 55 m, pastaj kthen drejt juglindjes neper boshtin e rruges së njejte në gjatesi prej 15 m, pastaj kthen drejt veriut në gjatesi prej 20 m dhe kthen drejt lindjes neper kufirin jugor të PK 4686 deri në piken fillestare të kufirit lindor.

Neni 4

(1) Zona e kontaktit e "Teresise monumentale të Krusheves" eshte me siperfaqe të pergjithshme prej 91 ha, me kufijte si vijojne:

- LINDJE: Kufiri lindor i zones së kontaktit fillon në verilindje të qytetit, më saktesisht në v. q. "Tri rruget" me PK: 4637, në piken me koordinata X: 521690,43 dhe Y: 581003,54. Prej ketu vazhdon në jug në gjatesi prej 47,00 m, neper kufirin e PK: 4637. Pastaj vazhdon në jug neper kufirin e PK: 4252 në gjatesi prej 24,00 m, vazhdon në juglindje neper kufirin e PK: 4651 në gjatesi prej 15,40 m; vazhdon në drejtimin e njejte në gjatesi prej 13,20m neper kufirin e PK: 5645; pastaj shkon në jug neper kufirin e PK:4660 në gjatesi prej 58,40m; shkon në jug neper kufirin e PK:5645 në gjatesi prej 5,60m; pastaj shkon në juglindje neper kufirin e PK:5645 në gjatesi prej 19,40m; pastaj kthen në jug në gjatesi prej 33m, shkon neper kufirin e parceles së njejte në juglindje në gjatesi prej 64,30m, deri te rruga Krusheve-Prilep me PK: 5652; pastaj kufiri shkon neper boshtin e rruges rajonale Prilep-Krusheve në drejtim jugperendimor në gjatesi prej 136m, deri te kufiri verilindor i PK:5654. Prej ketu vazhdon në jug neper kufirin e PK:2027 deri te "Krushevska Reka" në gjatesi prej 95,50m; pastaj kufiri shkon në jug neper kufirin e PK:2587 deri te rruga e asfaltuar Krusheve -D.Hisar në gjatesi prej 191,50m, vazhdon drejt lindjes në gjatesi prej 98m, neper boshtin e rruges së asfaltuar Krusheve-D.Hisar me PK:5671; vazhdon në gjysmerreth neper boshtin e rruges së njejte në gjatesi prej 57m. Pastaj shkon drejt jugut neper kufirin e PK:2972/1 deri te kryqezimi për te hoteli "Montana" në gjatesi prej 271,50m, pastaj kufiri shkon në jugperendim neper kufirin e PK:2972/1 deri te v. q. "Porta", në gjatesi prej 453, 70m.

- JUG: Kufiri jugor i zones së kontaktit fillon prej pjeses jugperendimore të qytetit në piken me koordinata X: 521677,43 dhe Y: 579759,66. Prej koordinatave të permendura kufiri shkon drejt veriut në gjatesi prej 56,80m, neper kufirin e PK: 2486; prej ketu kthen në veriperendim neper kufirin e PK:2476 në gjatesi prej 31,55m, pastaj shkon në jugperendim gjithashtu neper kufirin e PK:2476 në gjatesi prej 118, 65m; kthen në veriperendim në gjatesi prej 43,60m; kthen në jug neper kufirin e parceles së njejte në gjatesi prej 37,50m; prej ketu kufiri i zones së kontaktit shkon në perendim neper kufirin e PK:2472/1 në gjatesi prej 56,25m; shkon në perendim neper kufirin e PK: 2472 në gjatesi prej 78,20m, e pret rrugen me PK:6483 dhe shkon në perendim neper kufirin e PK:6482 në gjatesi prej 431m.

- PERENDIM: Kufiri perendimor i zones së kontaktit fillon prej pjeses jugperendimore të qytetit në piken me koordinata X: 520945,98 dhe Y: 579863,63. Prej ketu kufiri kthen në veriperendim neper kufirin e PK:6482 në gjatesi prej 97m, vazhdon në veri neper kufirin e parceles së njejte në gjatesi prej 69m, prej ketu vazhdon në jugperendim afer korijes së Krusheves neper kufirin e PK:6482 në v.q. "Guma" në gjatesi prej 534m, deri te shtylla e fundit e teleferikut prej ku kufiri leshohet në lindje deri te rruga e paasfaltuar që gjendet në korije në

gjatesi prej 252,50 m. Prej ketu kufiri vazhdon në veriperendim neper rrugen që shkon neper korine neper kufirin e PK:2442 në gjatesi prej 366,10m; shkon në veri gjithashtu neper kufirin e PK:2442 në gjatesi prej 165 m. Pastaj kufiri kthen në lindje neper kufirin e PK:2451 në gjatesi prej 44m.; vazhdon në lindje neper kufirin e PK:4484 në gjatesi prej 17m; vazhdon në lindje neper kufirin e PK:4488 në gjatesi prej 81,80m; vazhdon në drejtimin e njejte neper kufirin e PK:4484 në gjatesi prej 236, 20m; kthen drejt perendimit neper kufirin e parceles së njejte në gjatesi prej 48m; e pret rrugen me PK:4478, në gjatesi prej 25m; prej ketu leshohet drejt veriut neper kufirin e PK:4475 në gjatesi prej 47m; vazhdon neper drejtimin e njejte neper kufirin e PK:4380 në gjatesi prej 45m.

- VERI: Kufiri verior i zones së kontaktit fillon prej pikes në pjesen veriperendimore të qytetit të Krusheves me koordinatat X: 520787,03 dhe Y: 580933,52. Pastaj kufiri i zones së kontaktit shkon drejt lindjes neper kufirin e PK:4478 në gjatesi prej 51.60m; prej ketu kufiri vazhdon drejt veriut neper kufirin e PK:4478 në gjatesi prej 5,70; vazhdon neper kufirin e PK:4328 në gjatesi prej 14,90m; kthen në verilindje neper kufirin e PK:4377 në gjatesi prej 30m; vazhdon neper kufirin e PK:4353 në gjatesi prej 9,30m; shkon në drejtimin e njejte neper PK:4352 në gjatesi prej 15,10m; e pret rrugen me PK:6516 në gjatesi prej 3,70m dhe shkon në drejtimin e njejte neper kufirin e PK:4354 në gjatesi prej 24,50m; perseri e pret rrugen me PK:6516 në gjatesi prej 5m dhe vazhdon neper kufirin e PK:4342 në gjatesi prej 26m; Prej ketu kufiri vazhdon neper boshtin e rruges "Tome Nikle" afer kufirit të Fabrikes "Ilindenka" me PK:4332 në gjatesi prej 88m; kthen në veri neper kufirin e njejte në gjatesi prej 66,40m; e pret rrugen e asfaltuar Kursheve-f. Pusta Reke me PK: 6508/1 në gjatesi prej 32,50m dhe vazhdon në lindje neper boshtin e rruges "Nikolla Karev" me PK:4973 në gjatesi prej 116m; kthen në gjysmerreth drejt jugut në gjatesi prej 12m; perseri shkon në lindje në drejtim të varrezave të qytetit në gjatesi prej 35m; shkon në juglindje neper boshtin e rruges "Kiro Fetak" me PK:6507 në gjatesi prej 74m.; kthen drejt lindjes neper boshtin e rruges së njejte neper kufirin e PK:4222 në gjatesi prej 119m. Kufiri i zones së kontaktit vazhdon në lindje neper kufirin e PK:4221/2 në gjatesi prej 31,50m; vazhdon neper kufirin e PK:4256 në gjatesi prej 178m; pastaj kufiri e pret rrugen me PK:4739 në gjatesi prej 5,50 m; kthen në jug neper kufirin e PK:4259 në gjatesi prej 25m; shkon drejt lindjes neper kufirin e parceles së njejte në gjatesi prej 31,50m dhe e pret rrugen me PK:4739 në gjatesi prej 12.80m; prej ku edhe filloi kufiri lindor i zones së kontaktit në piken me koordinata X: 521690,43 dhe Y: 581003,54.

Neni 5

(1) Kufijte e "Teresise monumentale të Krusheves" dhe të zones së saj të kontaktit nga nenet 3 dhe 4 të ketij ligji (në tekstin e metejme: rajon i mbrojtur), Agjencia për kadafter të patundshmerive i projekton në baze gjeodezike në perpjesetim 1:1000.

(2) Organi nga paragrafi (1) i ketij neni për çdo parcele kadastrale që gjendet në kufijte e rajonit të mbrojtur, në dokumentacionin dhe evidencen kadastrale shenon verejtje se eshte pjese perberese e "Teresise monumentale të Krusheves" si trashegimi kulturore me rendesi të vecante, e për çdo të mire të mbrojtur të vecante në kufijte e rajonit të mbrojtur shenon verejtje se ka status të trashegimise kulturore me kategori adekuate të percaktuar me aktin për shpallje të saj.

(3) Kufijte e rajonit të mbrojtur nga paragrafi (1) i ketij neni nuk mund të ndryshohen me plan hapesinor dhe urbanistik as me lloj tjeter të aktit, pervec me akt për mbrojtje ose akt për ndryshim të mbrojtjes në pajtim me rregullat për mbrojtje të trashegimise kulturore.

Neni 6

(1) Për mbrojtje, rregullim, revitalizim dhe shfrytezim racional të "Teresise monumentale të Krusheves", Komuna e Krusheves miraton plan të detajuar urbanistik me perfshirje të planit në kufijte e "Teresise monumentale të Krusheves" nga neni 3 i ketij ligji.

(2) Për zonen e kontaktit nga neni 4 i ketij ligji, Komuna e Krusheves miraton plane të detajuara urbanistike.

(3) Planet nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni, perpilohen në baze të bazave mbrojtese-konservuese, të perpiluara nga Institucioni Nacional - Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe Muzeu -Prilep, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimise kulturore.

(4) Bazat mbrojtese - konzervuese për rajonin e mbrojtur "Teresia monumentale e Krusheves", detyrimisht permbajne masa të lejuara dhe restriktive për çdo pjese perberese të vecante në rajonin e mbrojtur.

(5) Bazat mbrojtese - konzervuese nga paragrafi (3) i këtij neni, që jane miratuar dhe verifikuar nga Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimise Kulturore, detyrimisht inkorporohen në planet e detajuara urbanistike, si kushte të vecanta për ndertim për çdo parcele ndertimore në vecanti.

Neni 7

Në "Teresine monumentale të Krusheves" nuk guxon:

- 1) të ndryshohet rrjeti i ekzistues i komunikacionit;
- 2) të perdoren materiale artificiale për perpunimin e rrjetit të komunikacionit (rrugeve, trotuareve dhe shesheve);
- 3) të vendosen hidrante mbitokesore të ujit për mbrojtje nga zjarri;
- 4) muret mbeshtetese dhe ndarese ndermjet oborreve dhe rrugeve të behen nga material tjetër përvec gurit;
- 5) të ndryshohen rrethojat ekzistuese autentike të oborreve;
- 6) të ndryshohet struktura ekzistuese e ndertuar dhe e pandertuar (forma e blloqeve, madhesia, forma dhe permbajtja e parcelave);
- 7) të ndryshohet gabariti i të mirave të mbrojtura individuale;
- 8) të ndryshohen lartesia dhe pamja e fasades së të mirave të mbrojtura individuale dhe të objekteve ambientale;
- 9) të ndryshohet mbulesa autentike e kulmit nga pllakat e gurit e të mirave të mbrojtura individuale;
- 10) të vendosen roleta të jashtme të plastikes në të mirat e mbrojtura individuale;
- 11) të vendosen pajisje të klimes në fasadat e rrugeve;
- 12) të ndertohen objekte me kate më të medha se P+2, duke llogaritur kuoten më të ulet të objektit;
- 13) të ndertohen objekte të reja të cilet si lartesi kane galeri ose nenkulm, pa ose me oxhaqe ose jane mbuluar me tarrace të rrafshet;
- 14) të vendosen kolektore solare që nuk jane në rrafsh me kulmin;
- 15) të mbulohen objektet me teneqe, pullazina, salonit dhe mbulesa bashkekohore të kulmit;
- 16) të ndertohen garazhe si objekte të posacme të parcelës ndertimore;
- 17) të rriten gabariti dhe lartesia e objekteve ndihmese të të mirave të mbrojtura individuale;
- 18) të vendosen dedikime të reja që shkaktojne zhurme dhe ndotje të rrethines së rajonit të mbrojtur;
- 19) të parkohet afer të mirave të mbrojtura të vecanta dhe të formohen vende parkimi afer tyre dhe
- 20) të vendosen antena, repetitore, bilborde dhe pano reklamimi të së mires së mbrojtur të vecante.

Neni 8

Regjimi i mbrojtjes në "Teresine monumentale të Krusheve" realizohet sipas kushteve të percaktuara hollesisht në planin e detajuar urbanistik nga neni 6 paragrafi (1) i këtij ligji, që miratohet për teresine monumentale, si dhe sipas kushteve të vecanta mbrojtese-konservuese që kane të bejne me:

- 1) interpolimin e kontrolluar të lokacioneve të reja të hapësirave të lira;

2) ruajtjen e të mirave të mbrojtura në gjendje burimore nepermjet konservimit, sanimit dhe në raste të jashtezakonshme me perteritje faksimile;

3) ruajtjen e objekteve ambientale që kontribuojne për vlerat dhe pasqyren ambientale të teresise në gjendje burimore, vecanerisht të pamjes së jashtme të objekteve me konservim dhe sanim, si dhe me restaurimin e pamjeve karakteristike të fasadave në objektet që kane demtime të medha;

4) kthimin e fondit të humbur të objekteve të lokacioneve që jane të lira dhe për të cilat ekzistojne plane të vjetra urbanistike, mbetje nga objektet ose fotodokumentacion dhe dokumentacion teknik nepermjet perteritjes së tyre tipologjike;

5) kthimin e pamjes autentike të fasades së objekteve që e kane humbur, e për të cilat ekzistojne mjaft informata për pamjen burimore;

6) rikompozimin e patundshmerive me dedikim në objektet që perterihen në menyre krahasuese;

7) mbajtjen e objekteve ambientale në kuader të gabariteve ekzistuese me mundesi për ndertime më të vogla shtese në lokacione të veta që nuk do të ndikojne në menyre drastike në ndryshimin e ambientit;

8) mbajtjen dhe ndertimin e objekteve me kulme në më shume kende me pjerresi të vogel (maks. 22% deri 24%), e për objektet që jane në sere kulmesh të dy kende me pjerresi të vogel, me perdorim të tjegullave të lakuara si material për mbulim, pervec te të mirat e mbrojtura te të cilat mbahet kulmi me pllaka guri;

9) mbajtjen e fasades së perdheseve dhe të perdheseve të larta nga guri i thyer, nderkaq katet të jene të suvatuara dhe të gelqerosura;

10) mbajtjen e ngjyres autentike të objekteve të mbrojtura dhe ambientale;

11) mbajtjen e ritmit harmonik të vendosjes së dritareve prej druri methurje të drurit, thurjeve karakteristike prej druri në fasade, pjerresirave prej druri dhe kornizave të perpunuara në menyre karakteristike;

12) mbajtjen dhe mirembajtjen e funksioneve themelore ekzistuese të carshise së Krusheves dhe kthimin e disa funksioneve burimore, siç jane zejtarite e vjetra ose dhenia e funksioneve të reja moderne disa objekteve, nese ato funksione jane kompatible me natyren e tyre dhe karakterin e teresise monumentale;

13) vendosjen e të gjitha llojeve të vijave të infrastruktures dhe instalimeve që të mos jene të dukshme në fasadat perballe rrugeve dhe në hapësiren e teresise monumentale;

14) mbajtjen e asfaltit në rruget frekuentuese motorike të komunikacionit që tanime jane të asfaltuara;

15) vendosjen në procedure në pajtim me ligjin, e të gjitha të mbishkrimeve të firmave dhe mbishkrimeve tjere, shenjave të komunikacionit, sinjalistikes monumentale, ndricimit dhe pajisjes urbane në vendet e hapura në teresine monumentale dhe

16) marrjen e masave preventive dhe korrektuese kunder efekteve shkaterruese nga zhurma, goditjet dhe vibracionet e shkaktuara nga makinat dhe automjetet në teresine monumentale.

Neni 9

(1) Në zonen e kontaktit të “Teresise monumentale të Krusheves” nuk guxon:

1) të ndryshohen gabariti, lartesia dhe pamja e fasades së të mirave të mbrojtura individuale;

2) të ndryshohet rrjeti rrugor ekzistues;

3) të ndertohen objekte në pjeset e pyllzuara të qytetit (korijet, objektet hotelierike) dhe

4) të kryhen intervenime që mund ta rrezikojne integritetin e të mirave të mbrojtura individuale në rreze prej 15 m rreth objekteve.

(2) Regjimi i mbrojtjes në zonen e kontaktit realizohet sipas kushteve të percaktuara hollesisht në planin e detajuar urbanistik nga neni 6 i ketij ligji, e që kane të bejne me zonen e kontaktit, si dhe sipas kushteve të vecanta mbrojtese-konservuese që kane të bejne me:

- 1) ruajtjen e të mirave të mbrojtura individuale në gjendje burimore nepermjet konservimit, sanimit dhe në raste të jashtezakonshme me perteritje krahasuese;
- 2) ruajtjen e kulmeve me më shume kende me perdorim të pllakave prej guri në të mirat e mbrojtura të vecanta dhe
- 3) harmonizimin e lartesisë dhe gabariteve të objekteve të reja të ndertuara, në menyre me të cilën pamundesohet mbyllja e pamjeve drejt teresisë monumentale.

Neni 10

- (1) Komuna e Krusheves dhe organet e saj dhe sherbimet publike janë pergjegjese për zbatimin e masave dhe aktiviteteve në zonen e mbrojtur në kuader të kompetencave të tyre të percaktuara me kete ose me ligj tjetër.
- (2) Pronaret e trashegimise kulturore në kuader të zones së mbrojtur janë pergjegjes sipas ligjit për mirembajtje, ruajtje, respektim dhe shfrytezim të drejte të trashegimise kulturore në kuader të zones së mbrojtur.
- (3) Institucioni Nacional – Enti për Mbrojtje të Monumenteve të Kultures dhe Muzeu - Prilep është pergjegjes për marrjen e masave mbrojtese-konservuese në zonen e mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashegimise kulturore.

Neni 11

- (1) Me “Teresine monumentale të Krusheves” në emer të Republikes së Maqedonise, e në pajtim me kompetencat e tyre, menaxhojne Institucioni Nacional – Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kultures dhe Muzeu – Prilep dhe komuna e Krusheves.
- (2) Për sigurimin e kushteve të vecanta për ruajtje permanente të teresisë monumentale dhe për menjanimin e shkaqeve që i rrezikojne vlerat e saj, si dhe për pune të koordinuar të organeve kompetente në realizimin e iniciativave të perbashketa, aksioneve ose projekteve për mbrojtje, rregullim, shfrytezim dhe revitalizim të “Teresise monumentale të Krusheves”, miratohet plan për mbrojtje të integruar të “Teresise monumentale të Krusheves” (në tekstin e metejme: “plani për mbrojtje të integruar”).

Neni 12

- (1) Planin për mbrojtje të integruar nga neni 11 paragrafi (2) të ketij ligji, e perpilon Drejtoria për Mbrojtje të Trashegimise Kulturore, në bashkepunim me Institucionin Nacional - Enti për Mbrojtje të Monumenteve të Kultures dhe Muzeu - Prilep dhe Komuna e Krusheves, për periudhe prej pese vitesh, ndersa e miraton ministri i Kultures.
- (2) Plani për mbrojtje të integruar para miratimit të tij vendoset në debat publik që zgjat së paku 30 dite.
- (3) Plani për mbrojtje të integruar vecanerisht i permбан:
 - pasqyren e objekteve të vecanta të shpallura për trashegimi të patundshme kulturore që janë në perberjen e “Teresise monumentale të Krusheves” (numri, siperfaqja, dedikimi i tanishem, dedikimi i ardhshem, valorizimi/revalorizimi),
 - pasqyren dhe vleresimin e situatave me pjese të vecanta ose ndertime në perberjen e “Teresise monumentale të Krusheves”,
 - propozimet për sanim, mbrojtje, ndertim dhe ndryshim të dedikimeve të objekteve në perberje të “Teresise monumentale të Krusheves”,
 - identifikimin e faktoreve potenciale dhe rreziqeve që i rrezikojne vlerat e trashegimise kulturore,
 - planifikimin e zhvillimit urban dhe rehabilitimit urban në “Teresine monumentale të Krusheves”,
 - zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e vetedijes publike për rendesine e trashegimise kulturore,

- percaktimin e drejtimeve për zhvillimin e turizmit kulturor në pajtim me principin e zhvillimit të qendrueshëm,
- zhvillimin e aktiviteteve për botimin e publikimeve shkencore dhe profesionale, publikimeve me karakter informativ,
- pasqyren e mjeteve të nevojshme për zbatimin e tij dhe
- pasqyren e organizimit dhe dinamikës së realizimit të aktiviteteve në infrastrukturen komunale të “Teresise monumentale të Krusheves”.

Neni 13

(1) Ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të planit për mbrojtjen e integruar nga neni 11 paragrafi (2) të këtij ligji, kryen keshilli mbikeqyrës (në tekstin e metutjeshëm: “keshilli”), i përbërë nga kryetari dhe dhjetë anëtarë, të cilët i emëron ministri i Kulturës.

(2) Në Keshill emërohet nga një përfaqësues nga:

- Ministria e Kulturës,
- Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore,
- Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor-Drejtoria për Mjedis Jetësor,
- Ministria e Transportit dhe Lidhjeve,
- Ministria e Ekonomisë,
- Ministria e Vetëadministrimit Lokal,
- Institucioni Nacional – Qendra Konservatore Nacionale – Shkup,
- Komiteti Nacional i Keshillit Nderkombëtar për Monumente dhe Vende –IKOMOS i Republikës së Maqedonisë.

Dy përfaqësues në keshill emërohen nga shoqata që veprojnë në planin e zhvillimit të turizmit dhe prezantimit të Krusheves.

(3) Kryetari dhe anëtarët e keshillit kanë mandat prej dy vitesh, me të drejtë që të riemërohen edhe për një mandat.

(4) Keshilli njëherë në vit të ministri i Kulturës dorëzon raport për realizimin e planit për mbrojtjen e integruar dhe propozime të masave për përmirësimin e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe prezantimit të “Teresise monumentale të Krusheves”,

(5) Në raportin nga paragrafi (4) i këtij neni përfshihen vlerësimi për masat e dhe rekomandimet marra për tejkalimin e gjendjeve.

II. MBIKEQYRJA

Neni 14

(1) Mbikeqyrjen e zbatimit të këtij ligji e kryen Ministria e Kulturës.

(2) Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore kryen mbikeqyrje inspektuese mbi zbatimin e rregullave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në pajtim me këtë ligj.

(3) Mbikeqyrje të dispozitave të këtij ligji që janë në lidhje me zbatimin e rregullave për ndërtim dhe planifikim hapësinor dhe urbanistik, kryejnë organet kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e ndërtimit dhe rregullimit hapësinor.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 15

(1) Planet detajore urbanistike nga neni 6 i këtij ligji do të miratohen në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në miratimin e planeve nga paragrafi (1) i këtij neni, mbrojtja e “Teresise monumentale të Krusheves” realizohet me dhenien detyrimit të kushteve konservuese mbrojtëse që i miraton Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, me kërkesë të organit kompetent për dhenien e lejes për ndërtim, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 16

(1) Plani për mbrojtjen e integruar nga neni 11 paragrafi (2) të ketij ligji do të miratohet më së voni deri në gjashte muaj nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

(2) Keshillin nga neni 13 i ketij ligji, do ta emeroje ministri i Kultures në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise”.